

E L James

GREI

Roman

Përktheu nga origjinali: M B Bako

Botimet
DRITAN
Tirana

Titulli i originalit: Grey, E L James.

Copyright © 2011, 2015 Fifty Shades Ltd.

All rights reserved. No part of this publication may be reproduced or transmitted, in any form or by any means, without permission of the publishers.

© Për Përkthimin: Botimet DRITAN – TIRANË.

Të gjitha të drejtat e riprodhimit, përshtatjes janë të rezervuara për botuesin; çdo riprodhim i plotë apo i pjesshëm i çfarëdoshëm i këtij libri në çdo rrugë qoftë, veçanërisht përmes fotokopjimit apo mikrofilmit, është absolutisht i ndaluar pa autorizimin me shkrim të botuesit.

Pjesë të këtij libri, kryesisht dialogë dhe këmbime i-meilesh, janë shfaqur më herët në veprat e tjera të autores.

ISBN: 978-9928-184-19-1

Redaktoi: Vladimir Bako

Cover design by Sqicedragon and Megan Wilson

Dritan Editions - Tirana Bulevardi "Bajram Curri", Aviacioni i Ri, 7/51, Tirana, Albania. Tel.&Fax: 00355 4 222 40 44 Tel.: 00355 4 224 57 09 E-mail: botimetdritan@gmail.com

LIBRA NGA E L JAMES

Pesëdhjetë Hijet e Greit
Pesëdhjetë Hije më të Errëta
Pesëdhjetë Hije të Çliruara
Grei

*Ky libër u kushtohet atyre lexuesve që e kërkuan... e
kërkuan... e kërkuan... dhe e kërkuan.
Ju faleminderit për gjithçka keni bërë për mua
Ju ma mbushni shpirtin çdo ditë me gëzim.*

GREI

E L JAMES

FALËNDERIME

Falënderoj:

Anne Messitte për humorin e mirë, që më ka udhëzuar dhe që ka pasur besim tek unë. I jam përjetë në borxh për bujarinë me kohën e saj dhe përpyekjen e pakufizuar për të shpleksur prozën time.

Tony Chirico dhe Russell Perreault që janë kujdesur gjithnjë për mua dhe ekipin e mrekullueshëm redaksional dhe të dizajnit që e panë këtë libër përtej vijës së finishit: Amy Brosey, Lydia Buechler, Katherine Hourigan, Andy Hughes, Claudia Martinez dhe Megan Wilson.

Niall Leonard për dashurinë, mbështetjen, udhëzimet dhe për faktin që është i vetmi burrë që mund të më bëjë të qesh me të vërtetë.

Valerie Hoskins, agjentin time, pa të cilën do të isha ende duke punuar në televizion. Faleminderit për gjithçka.

Kathleen Blandino, Ruth Clampett dhe Belinda Willis: faleminderit që e lexuat paraprakisht.

The Lost Girls për miqësinë dhe terapinë e tyre të çmuar.

The Bunker Babes për mprehtësinë, urtësinë, mbështetjen dhe miqësinë e vazhdueshme.

Zonjat FP që më ndihmuan me amerikanizmat.

Peyer Branston që më ndihmoi me TSHPZ.

Brian Brunetti që më udhëzoi të drejtoja një helikopter.

Profesor Dawn Carusi për ndihmën në eksplorimin e sistemit të lartë arsimor të Shteteve të Bashkuara.

Profesor Chris Collins që më dha mësim në shkencën e tokës.

Dr. Raina Sluder që më ndihmoi të kuptoja shëndetin e sjelljes.

Dhe të fundit, po kurrsesi më pak të rëndësishmit, fëmijët e mi. Ju dua më shumë se ç' mund të shprehin fjalët. Ju mbushni me kaq shumë gëzim jetën time dhe të atyre që ju rrethojnë. Jeni djem të bukur, zbavitës, të mëshirshëm dhe ndihem pafundësisht krenare për ju.

E HËNË, 9 MAJ, 2011

Kam tri makina. Ato rrëshqasin shpejt nëpër dysheme. Shumë shpejt, njëra është e kuqe. Njëra jeshile. Njëra e verdhë. Më pëlqen jeshilja. Është më e mira. Edhe mami i pëlqen makinat e mia. Kënaqem kur mami luan me mua me makina. Ajo pëlqen më fort të kuqen. Sot mami qëndron ulur në kanape me vështrimin ngulur në mur. Makina jeshile fluturon në sixhade. E kuqja e ndjek pas. Pastaj e verdha. Përplasen! Po mami nuk e sheh përplasjen. E bëj përsëri. Përplasen! Po mami nuk i sheh. E shtyj makinën jeshile drejt këmbëve të saj. Mirëpo makina jeshile hyn nën divan. Nuk e arrij dot. Dora ime është tepër e madhe për t'u futur në hapësirën poshtë divanit. Mami nuk sheh. Dua makinën time jeshile. Po mami qëndron në divan me sytë nga muri. *Mami. Makina.* Ajo nuk më dëgjon. *Mami.* E tërheq nga dora, por ajo shtrihet në shpinë dhe mbyll sytë. *Jo tani, Krimb. Jo tani,* thotë ajo. Makina ime jeshile qëndron nën divan. Gjithmonë nën divan. Mund ta shoh. Po nuk e arrij dot. Makina jeshile është me push. Mbuluar me push gri dhe pisllek. E dua përsëri. Po nuk e arrij dot. Nuk do ta arrij kurrë. Makina jeshile humbi. Dhe nuk mund të luaj më kurrë me të përsëri.

Hap sytë dhe ëndrra zbehet nën dritën e mëngjesit herët. *Për çfarë dreqin ishte kjo?* Shtrëngoj copëzat teksa tërhiqen, po nuk arrij të kap asnjërën prej tyre.

E largoj nga mendja, siç bëj shumicën e mëngjeseve, zbres nga

shtrati dhe gjej një palë tuta të porsalara në dhomën-gardërobë. Jashtë, qielli i ngarkuar premtion shi dhe nuk jam në humor të lagem nga shiu gjatë vrapit të sotëm. Ngjitem lart në palestrën time, ndez televizorin për lajmet mëngjesore të biznesit dhe hipi në pistën e vrapit.

Mendimet më arrakaten te punët e ditës. Nuk kam asgjë përveç takimeve, ndonëse do të shihem me trajnerin personal më vonë për një stërvitje në zyrën time – Bastilli është përherë një sfidë e mirëpritur.

Ndoshta duhet t'i telefonoj Elenës?

Po. Ndoshta. Mund të darkojmë ndonjë mbrëmje gjatë javës.

Ndaloj pistën e vrapit dhe zbres poshtë në dush për të nisur një tjetër ditë monotone.

- NESËR, - MËRMËRIS PËR TA HEQUR QAFE Klod Bastillin, i cili po qëndron në prag të zyrës sime.

- Golf, këtë javë, Grei. – Bastilli ngërdheshet me arrogancë të shkujdesur, duke e ditur mjaft mirë që e ka të sigurt fitoren në fushën e golfit.

I ngrysem teksa kthehet dhe shkon. Fjalët e tij sikur m'u hedhin kripë plagëve, ngaqë, pavarësisht përpjekjeve të mia heroike në palestër sot, trajneri personal ma bëri bythën shoshë. Bastilli është i vetmi që mund të më rrahë dhe tani kërkon akoma të më rrjepë lëkurën në fushën e golfit. E urrej golfin, po në fushat e tij bëhet goxha biznes, ndaj jam i detyruar të duroj leksionet e tij edhe atje... megjithëse duhet ta pranoj, ndeshja kundër Bastillit ka filluar të ma përmirësojë goxha lojën.

I ngul sytë horizontit të Siatëllit dhe vetëdijen ma depërton mërzia e njohur. Shpirtin e kam të flashkët dhe gri si moti. Ditët e mia përzihen me njëra-tjetrën pa dallim dhe kam nevojë për pak argëtim. Kam punuar gjithë fundjavën dhe tani, në kufizimin e vijueshëm të zyrës sime, nuk gjej rehat. Nuk duhej të ndihesha kështu, pas disa përplasjeve me Bastillin. Po ja që kështu është.

Vrenjtem. E vërteta e kthjellët është që kohët e fundit e vetmja gjë që më ka ngjallur interes ka qenë dërgimi i dy ngarkesave në Sudan. Se u kujtova... Rosi duhej të më raportonte për shifrat dhe logjistikën. *Pse dreqin po vonohet?* Kontrollon axhendën dhe marr telefonin.

Dreq! Duhet të duroj një intervistë me këmbëngulësen zonjushë

Kevëna për gazetën studentore të USHU-së. *Pse dreqin rashë dakord për këtë?* I urrej intervistat... pyetje boshe nga idiotë ziliqarë, të keqinformuar, që futin hundët në jetën time personale. Bie telefoni.

- Po, - ia kërcas Andreas, si të jetë faji i saj. Të paktën t'i bie shkurt me intervistën.

- Ka ardhur zonjushë Anastasia Stilli t'ju takojë, zoti Grei.

- Still? Po prisja Kethrinë Kevënanë.

- Këtu ndodhet zonjusha Anastasia Still, zotëri.

Ngrysem. E urrej të papriturën. - Fute brenda, - mërmëris, i vetëdijshëm që nga toni dukem si adoleshent gërnjar, po nuk më plas fare.

Mirë, mirë... zonjusha Kevëna qenka e padisponueshme. E njoh babanë e saj, Ejmënin, pronarin e Mediave Kevëna. Kemi bërë biznes bashkë dhe duket qenie njerëzore mendjemprehtë dhe racionale. Kjo intervistë është favor për të... që kam ndërmend ta kthej në para më vonë, kur të më duket e përshtatshme. Dhe duhet ta pranoj se vagullt jam kureshtar për të bijën, jam i interesuar të shoh nëse dardha ka rënë nën dardhë.

Më bën të brof në këmbë një turbullirë te dera, një vorbull flokësh të gjatë gështenjë, gjymtyrësh të zbehta dhe çizmesh bojëkafe, që më futet me kokë në zyrë. Përmbaj bezdinë e natyrshme nga një ngathtësi e tillë teksa nxitoj drejt vajzës që ka rënë mbi gjunjë dhe duar në dysheme. E kap nga supet e dobët dhe e ndihmoj të ngrihet në këmbë.

Sytë blu të kthjellët, të shndritshëm, të sikletosur ndeshin në të mitë dhe më ngrijnë në vend. Kanë ngjyrën më të jashtëzakonshme... të kaltër, të padjallëzuar... dhe për një çast të tmerrshëm, më duket se mund të më shohin tejpertej dhe ndihem... i pambrojtur. Mendimi më shkurajon, ndaj e largoj menjëherë nga koka.

Vajza ka fytyrë të vogël, të ëmbël dhe tani po skuqet, në një ngjyrë trëndafili të pafajshme. Për një hop vras mendjen nëse e gjithë lëkura e saj është kështu... e përsosur... dhe si do të dukej e skuqur dhe e nxehur nga goditja e një thupre.

Dreq.

Ndal mendimet e pabindura, i alarmuar nga drejtimi i tyre. *Çfarë dreqin po mendon, Grei?* Vajza është shumë e re. Ajo më sheh gojëshqyer dhe më vjen të rrotulloj sytë. *Po, po, shpirt, është thjesht një*

fytyrë dhe e bukur deri nën lëkurë. Dua ta davarit këtë vështrim admirues prej syve të saj, po le të bëjmë pak qejf ndërkohë!

- Zonjusha Kevëna? Jam Kristian Grei. Jeni mirë? Dëshironi të uleni?

Prapë ajo skuqja. Përsëri në kontroll, e këqyr mirë. Është goxha tërheqëse... truphollë, e zbehtë, me një krifë flokësh mogani, të cilët mezi ia mban një lidhëse flokësh.

Brune.

Po, është tërheqëse. I zgjat dorën dhe ajo mërmërit një shfajësim të përlulur dhe vendos dorën e vogël në timen. Lëkurën e ka të butë dhe të ftohtë, ndërsa shtrëngimin, çuditërisht të vendosur.

- Zonjusha Kevëna është pa qejf, ndaj më dërgoi mua. Shpresoj të mos jetë problem për ju, zoti Grei. - Zërin e ka të qetë, me një muzikalitet ngurrues, pulit sytë e çoroditur, qerpikët e gjatë i vibrojnë.

Pa mundur ta zhvesh zërin nga zbavitja teksa kujtoj hyrjen e saj më-pak-se-elegante në zyrën time, e pyes kush është.

- Anastasia Still. Studioj letërsi angleze me Kejtin, hëm... Kethrinën... hëm... zonjushë Kevënanë, në *Universitetin Shtetëror të Uashingtonit*.

Një tip nervoz, e dhënë pas librave, hë? Duket; e veshur keq, me trupin e hollë fshehur nën një pulovër pa formë, fund bojëkafe në formë kove dhe çizme praktike. *Nuk paska fare sens stili?* Vështron me nervozizëm rreth zyrës... gjithkund përveçse nga unë, vërej me ironi argëtuese.

Si mund të jetë gazetarë kjo grua e re? Nuk ka asnjë kockë sigurie në trupin e vet. Është e shqetësuar, e butë... e nënshtruar. Tund kokën, i habitur se ku më çojnë mendimet e mia të papërshtatshme dhe vras mendjen në janë të besueshme përshtypjet e para. Mërmëris njëfarë rëndomësie dhe i kërkoj të ulet, pastaj vërej vështrimin e saj të mprehtë teksa vlerëson pikturat në zyrën time. Para se ta ndal veten, kuptoj që po i shpjegoj. - Një artist i zonës. Truton.

- Janë shumë të bukura. Të ngresh të zakonshmen në nivelin e të jashtëzakonshmes, - thotë me ton ëndërrues, e përhumbar në mjeshtërinë fine, të jashtëzakonshme të veprës së Trutonit. Profili i saj është i bukur... hundë e ngritur lart, buzë të plota, të buta... dhe me fjalët e veta ka pasqyruar ekzaktësisht mendimet e mia. "*Të ngresh të*